



REPUBLIKA E KOSOVËS

Datë, 06.01.2025

Nr i prot 01/08



KOMUNA E MALISHEVËS

Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun

### **Plani i punës së Zyrës për Informim dhe Komunikim me Publikun për vitin 2025**

Ky Plan, bazohet në Statutin e Komunës, Rregulloren Komunale për Transparencë dhe Planin e Veprimit për Transparencë Komunale për vitet 2025-2029

#### **Ndër aktivitetet kryesore parashihen të jenë:**

- Publikimi i vendimeve të nënshkruara nga kryetari, përgatitja e lajmeve dhe njoftimeve për aktivitetet e kryetarit dhe drejtorive komunale, dërgimin i vendimeve të nënshkruara nga Kryetari në MAPL, publikimi i raportit të qeverisë komunale për vitin 2024, publikimi i planit të punës së qeverisë komunale për vitin 2025, pranimi i kërkesave për qasje në dokumente publike dhe kthimi i përgjigjes bazuar në ligjin për qasje në dokumente publike, Mbrojtja e të dhënave personale, publikimi i njoftimeve për mbledhjet e kuvendit komunal-KPF-së dhe Komitetit për Komunitete, përgatitja e njoftimeve për aktivitete përkujtimore, ngjarje e përvjetorë e për data të rëndësishme, publikimi i dokumenteve-rezultateve të përgatitura nga OJQ-të për transparencë dhe llogaridhënie për komunën e Malishevës, publikimi i konkurseve, publikimi i thirrjeve për aplikim, publikimi i ankandeve, publikime të tjera, sipas nevojës, kërkesave dhe interesave të komunës, Buletinët Strategjia Komunale për Komunikim.
- Dokumentet si: Raporte, rregullore, plane të ndryshme, plane financiare, njoftime, lajme, ftesa ankande publike, thirrje dhe publikimi i vendimeve të nënshkruara nga ana e kryetarit, ndikojnë direkt në rritjen e performancës, transparencës dhe llogaridhënies në komunën e Malishevës.

- -Vendimet (publikimi i tyre është rregulluar edhe me ligj) e nënshkuara nga kryetari i komunës, dërgohen në MAPL dhe publikohen në uebfaqe zyrtare të komunës në vegëzën: **komuna.malisheve@rks-gov.net** dhe
- **kkmalisheve@gmail.com** janë lehtë të qasshme nga ana e qytetarëve, mediat dhe OJQ-të por që nuk dërgohen për publikim tek mediat lokale dhe ato qendrore.
- Planet, rregulloret dhe dokumente tjera që duhet të kalojnë në debat publik, konsultim publik dhe dëgjime publike, publikohen edhe në platformën e konsultimeve publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

- 

**Malishevë, 6.01.2025** Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun  
Udhëheqës, Ma.sc. Izet Shala

Zyrtar për informim dhe medie, Artan Paçarizi